



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	30.06	2023	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
BRANISICK	4988/2023		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.798/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.798/2023 të datës 31.05.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit KA.nr.10/2023 të datës 24.04.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet e pabazuar ankesa me numër A.nr.798/2023 e datës 31.05.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.10/2023 i datës 24.04.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit : punësuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit me numër protokoll GJ.A Su.A 196/18 të datës 29.05.2018 në pozitën Referent i Lartë në Gjykatën Themelore në Gjilan, Shefja e Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve në këtë gjykatë më datë 15.03.2023 përmes aktit me numër protokoll GJ.A Su.A 136/2023 ka shqiptuar

masën disiplinore "Vërejtje me shkrim" me arsyetimin se në pjesën e paradites më datë 14.03.2023 nuk ka ardhur fare në punë duke mos njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë.

Ankuesi kundër kësaj mase më datë 20.03.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës e cila është pranuar më datë 23.03.2023. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 24.04.2023 ka nxjerr Vendim KA.nr.10/2023 me të cilin ka refuzuar ankesën e datës 23.03.2023 kundër "vërejtjes me shkrim" të datës 15.03.2023.

Ankuesi kundër Vendimit KA.nr.10/2023 të datës 24.04.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të cilën në bazë të fletë dorëzimit e ka pranuar më datë 27.04.2023, përmes postës më datë 26.05.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 31.05.2023 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.798/2023 me numër protokolli 4530/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.06.2023 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ndërsa Këshilli, më datë 27.06.2023 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4530/2023 të datës 31.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.10/2023 të datës 24.04.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Aktin me numër protokolli GJ.A Su.A 136/2023 të datës 15.03.2023 për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje me shkrim; Fletë dorëzim i datës 27.04.2023; Formularin e rezultateve në punë i datës 29.12.2022; Zarfën e datës 26.05.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 27.06.2023; Ankesën e datës 23.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për pushim vjetor e datës 15.03.2023; Deklaratë nga M.A dhe S.K; Raporti i vijueshmërisë në punë për datat nga 13-17.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.10/2023 të datës 24.04.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe aktit me numër protokoll GJ.A Su.A 136/2023 të datës 15.03.2023 për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim", pretendon se masa e shqiptuar është e kundërligjshme për shkak që unë e kam njoftuar më datë 13.03.2023 ku unë kam kërkuar gjysmë dite pushim, ndërsa mbikëqyrësja e drejtpërdrejt më datë 15.03.2023 ka ardhur në zyre dhe ka marr formularin e pushimit vjetor për datën 14.03.2023 ndërsa më shqipton masën disiplinore.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka shqyrtuar në tersi provat materiale të lëndës dhe mbi bazë të administrimit të tyre, konstaton se ankuesi në ankesën e tij të datës 31.05.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës thekson faktin që ka kërkuar gjysmë dite pushim më datë 14.03.2023, mirëpo nga provat e lëndës rezulton se i njëjti nuk ka qenë prezent në punë për tërë ditën edhe pse ka qenë i liruar vetëm për një pjesë të ditës, ngase kjo dëshmohet edhe sipas raportit të vijueshmërisë në punë për periudhën nga data 13-17.03.2023, ku rrjedh se më datë 14.03.2023, përveç që nuk është regjistruar në hyrje i njëjti nuk është regjistruar as në dalje. Për me tepër ankuesi ka përgatitur kërkesën për pushim vjetor për datën 14.03.2023, ndërsa mbikëqyrësja e drejtpërdrejt më datë 15.03.2023 ka refuzuar kërkesën për pushim vjetor për datën 14.03.2023, me arsyetimin se kjo kërkesë është paraqitur një ditë pasi që është shfrytëzuar pushimi, sepse i njëjti për ditën që kërkon pushimin ka qenë i liruar vetëm për gjysmë dite, kurse kërkesa është paraqitur për të arsyetuar mos kthimin në punë.

Lidhur me mungesën në punë për datën 14.03.2023, për një pjesë të ditës, Kolegji ju referuar edhe deklaratës së Referentes në Departamentin Civil S.A e cila ka theksuar se ankuesi më datë 14.03.2023 ka pyetur V.D për pushim për gjysmë dite ndërsa ka munguar tërë ditën, dhe deklaratës së Referentes së Lartë M.A e cila deklaroi se ankuesi ka marr leje për mungesë në punë për datën 14.03.2023 vetëm për gjysmë dite ndërsa nuk ka qenë në punë për ditën e plotë.

Bazuar në konstatimin e gjendjes faktike, rrjedhimisht deklarimeve të ankuesit, mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë në aktin për shqiptimin e masës disiplinore dhe deklaratave të kolegeve të ankuesit të dhëna për rastin konkret, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqë ankuesi për datën 14.03.2023 ka kërkuar lirim vetëm për gjysmën e ditës, i njëjti pa ndonjë leje të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt ka munguar tërë ditën, ndërsa ankuesi për këtë nuk ka lajmëruar mbikëqyrësin e drejtpërdrejt, pasi që i njëjti me asnjë prove nuk ka mund të argumentoj një gjë të tillë, si rrjedhojë, ankuesi ka qenë i detyruar të njoftoj mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të tij, për mungesë në punë, me ç'rast mos njoftimi bie në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 7 të Rregullores Nr.05/2010 për Orarin e Punës, ngase

nëpunësit civilë janë të detyruar t'i informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës dhe mos informimi ose mungesa e pa lajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin. Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës respektivisht nenin 63 paragrafi 1 dhe nenin 64 paragrafi 1, përcaktohet se nëpunësit civil janë përgjegjës për veprimet e tyre dhe në rast të veprimeve që bien ndesh me parimet e këtij ligji atëherë edhe i nënshtrohen masave disiplinore, mbi këtë bazë edhe ankuesi me veprimet e tij është bërë përgjegjës për shkelje të parimeve të këtij ligji duke mos respektuar orarin e punës dhe duke mos njoftuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë për mungesë në punë.

Kolegji i Këshillit, vlerëson se kërkesa e ankuesit e datës 15.03.2023 për pushim vjetor për datën 14.03.2023 dhe e cila kërkesë i është refuzuar, e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, i cili përcakton se: *"1. Nëpunësit civilë paraqesin kërkesë (shtojca nr.1 e kësaj rregulloreje) të udhëheqësi i tyre, së paku tri (3) ditë pune para fillimit të shfrytëzimit të pushimit vjetor, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 5 të kësaj Rregulloreje"*, ngase kërkesa për shfrytëzim të pushimit vjetor nuk mund të parashtrohet një ditë apo pas kohës kur nëpunësi ka shfrytëzuar pushimin, rrjedhimisht ankuesi kërkesën e ka parashtruar një ditë pasi që ka munguar në punë konkretisht ka qenë i liruar për një pjesë të ditës së punës, si rezultat i kësaj ankuesi përmes kërkesës për pushim vjetor është munduar të bëjë arsyetimin e mungesës në punë për datë 14.03.2023 për pjesën tjetër të datës të munguar në punë e të paarsyetuar.

Bazuar në konstatimin si më lartë, rezulton se ankuesi ka bërë shkelje të lehta disiplinore të përcaktuara me nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 dhe 1.7 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"1. Shkelje të lehta disiplinore konsiderohen: 1.1. shkeljet e lehta të Kodit të Mirësjelljes për nëpunësit civilë, 1.2. mosmbajtja e kartelës identifikuese; 1.3. dy mungesa të pa arsyeshme me kohëzgjatje njëditore brenda vitit kalendarik; 1.4. mosrespektimi i normave për veshjen dhe paraqitjen; 1.5. mos mbajtja në mënyrë të rregullt të shkresave dhe të të dhënave zyrtare që ndërlidhen me detyrat e punës; 1.6. mos respektimi i orarit të punës dhe 1.7. mosinformimi për mungesën në punë"*.

Andaj Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit me numër protokolli GJ.A Su.A 136/2023 të datës 15.03.2023 të Shefes së Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve në Gjykatën Themelore në Gjilan për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit, konstaton se masa disiplinore ndaj ankuesit është shqiptuar për shkelje të lehta disiplinore, është shqiptuar në raport të drejtë më shkeljen e bërë, dhe është shqiptuar mbi bazën e vlerësimit të drejtë të gjendjes faktike dhe si rezultat i kësaj kjo masë është shqiptuar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht nenin 66 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *"Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga sjellja e"*

*nëpunësit civil", ndërsa me nenin 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 pika 1.1.2, ku përcaktohet se: "Vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: 1.1. për shkelje të lehta aplikohen masat disiplinore në vijim: 1.1.1. paralajmërimi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.1.2. vërejtja me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 1.1.3. vërejtje me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion"* dhe nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.10/2023 të datës 24.04.2023, të njëjtin e ka arsyetuar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjen së Kontesteve dhe Ankesave, ngase janë shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që për shkak se ankuesi pretendimet e tij ankimore nuk ka arritur t'i argumentoj me prova materiale, pretendimet e tij janë të papabuzuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.798/2023, datë 30/06/2023

**Avdyll BEKTESHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.